

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR.1 TË MARRËVESHJES SË HUAS TË DATËS 31.12.2012, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË SË DIGËS NË HIDROCENTRALIN E KOMANIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.103/2013”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, të ratifikuar me ligjin nr.103/2013.

Qeverisë shqiptare, me anë të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, i është akorduar një kredi në shumën prej 12 700 000 eurosh për realizimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ku të gjitha aktivitetet e planifikuara janë realizuar 100%. Amendimi parashikon përdorimin e fondeve të mbetura pa u përdorur nga kredia e akorduar për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe remontit në HEC-in Koman, si një bashkëfinancim me Bankën Botërore, aktivitet ky që nuk ka qenë i përfshirë në marrëveshjen bazë. Amendimi i propozuar nuk cenon objektivin kryesor të programit për sigurinë e digave.

Objektivat e projektit janë rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të sistemit elektroenergjetik shqiptar në kaskadën e lumit Drin dhe rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshmërisë së sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është i paplanifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i ndryshimit të marrëveshjes, me qëllim përdorimin e fondeve të kursyera nga huaja gjatë zbatimit të aktiviteteve që ishin parashikuar për t'u implementuar në kuadër të projektit, të cilat janë zbatuar plotësisht. Fondet e kursyera do të jenë pjesë e paketës mbështetëse për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe remontit që do të financohet nga Banka Botërore për HEC-et Fierzë dhe Koman. Amendimi parashikon financimin e rehabilitimit të portave të HEC-it Koman dhe Banka Botërore do të bashkëfinancojë pjesën e mbetur të kësaj kontrate.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji mbështetet në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës. Procedura është në përputhje me nenet 17 e 23, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Ndryshimi i marrëveshjes së huas dhe i projektit u miratua në parim me vendimin nr.529 datë 11.9.2018, të Këshillit të Ministrave, u nënshkrua ndërmjet palëve dhe po i nënshtrohet procedurës që parashikon kuadri ligjor në fuqi për bërjen efektive të saj, konkretisht, procedurës së ratifikimit me ligj.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë

dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit.

Marrëveshja ndryshuese parashikon, si më poshtë vijon:

- Zëvendësimin e të dhënave që përfshihen në skedulet 1 e 2, të marrëveshjes së huas, me skedulet 1 e 2, të marrëveshjes ndryshuese nr.1, ku, konkretisht, synohet:
 - përdorimi i pjesës së kredisë, e mbetur pa përdorur në vlerën prej 6 128 224 eurosh, për realizimin e aktiviteteve shtesë në kuadër të projektit e sipas skeduleve 1 e 2;
 - Shtyrja e afatit të përfundimit të projektit, si dhe e afatit të përdorimit të fondeve të kredisë deri më 31.12.2021, me qëllim mundësimin e investimeve të shtuara në projekt;
- Zëvendësimin e emërtimeve “Ministria e Financave” dhe “Ministri i Financave” përkatësisht me “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” dhe “Ministri i Financave dhe Ekonomisë”, përgjatë të gjithë tekstit të marrëveshjes;
- Ndryshimin e adresës së huamarrësit, në nenin 6.01, sipas vendndodhjes aktuale.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e ligjit ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).

Zbatimi i projektit realizohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), ndërsa projekt marrëveshja, si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Projektligji është bashkërenduar me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Drejtësisë, të cilat janë shprehur dakord.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kredia e akorduar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), nëpërmjet marrëveshjes së huas, ka vlerën e 12 700 000 eurove.

Dokumenti ndryshues i propozuar, për rrjedhojë, edhe projektligji në fjalë, nuk marrin përsipër detyrime financiare shtesë nga ato që parashikon marrëveshja e huas (pra, nuk kemi akordim të ndonjë financimi shtesë), por, për arsye se gjatë zbatimit të projektit fillestar kanë mbetur fonde pa përdorur në vlerën 6 128 224 euro, nëpërmjet këtij dokumenti ndryshues, këto fonde do të mund të përdoren për të realizuar investime të tjera shtesë.

Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të KESH, sh.a., për periudhën 2018-2020.

KËSHILLI I MINISTRAVE